





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



RAPORT MBI FUNKSIONIMIN E WEB-FAQEVE ZYRTARE TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Janar, 2009

Hyrje

Me qëllim të transparencës së punës së Komunave në raport me qytetarët, mediat, organizatat joqeveritare dhe palëve tjera të interesuar t'i lejohet qasje pa përjashtim në punën dhe aktivitetet e Komunave dhe në të gjitha dokumentet zyrtare, ato prezantojnë aktivitetet e përditshme të tyre dhe çështje tjera, në web-faqet zyrtare.

Prezantimi i aktiviteteve të Komunave në web faqet e tyre zyrtare është me rëndësi për informim të qytetarëve dhe institucioneve tjera me punën e këtyre institucioneve. Konkretisht, përmes këtyre Ueb faqeve qytetarët dhe institucionet tjera do të mund të informohen me strukturën organizative, detyrat përgjegjësitë, aktivitetet dhe dokumentet e ndryshme të komunave.

Në kuadër të planit të punës, Departamenti për Vetëqeverisje Lokale (DVL)ka bërë edhe monitorimin e Ueb faqeve të komunave.

DVL monitoron ueb-faqet e komunave me qëllim të vlerësimit të transparencës së komunave në raport me qytetarët, mediat, organizatat joqeveritare dhe palëve të tjera të interesuara dhe sipas evidentimit të gjendjes së web-faqeve ka dhënë rekomandimet përkatëse për secilën Komunë veç e veç.

Vlerësimi i gjendjes aktuale të ueb faqeve komunale

Gjatë monitorimit të web faqeve komunale është konstatuar se web faqet funksionojnë në këto komuna:

Kamenicë, Istog, Vushtrri, Glogoc, Junik, Skenderaj, Podujevë, Shtime, Pejë, Prishtinë, Obiliq, Prizren, Rahovec, Deçan, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Klinë, Malishevë, Suharekë, Lipjan, Mitrovicë dhe Kaçanik, ndërsa web faqja nuk ekziston në këto komuna: Hani i Elezit, Mamushë, Viti, Fushë Kosovë, Dragash, Novobërdë dhe Shtërpçë.

**Evidentimi i të dhënave në linçet e veçanta në web-faqet zyrtare për
Komunat e Republikës së Kosovës**

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Fjala e kryetarit, struktura organizative, buxheti, vërejtjet e qytetarëve.

Fjalimi i kryetarit të komunës së Podujevës është paraqitur në web-faqen e komunës. Struktura organizative është e paraqitur në mënyrë tabelore, Ekziston edhe vendimi për miratimin e buxhetit të komunës, ndërsa, tek linku për vërejtjet e qytetarëve nuk ka të dhëna.

Për qytetin

Historiku, pozita gjeografike, kultura, sporti, ekonomia, galeria, harta.

Këtu gjenden të dhënat lidhur me historinë e qytetit, pozita gjeografike e komunës së Podujevës. Në likun për kulturë janë të dhënat lidhur me aktivitetet e komunës numri i shkollave, sporti, po ashtu aktivitetet sportive. Tek ekonomia janë të dhënat për zhvillimin e sektorit privat në komunë. Galeria dhe harta nuk kanë të dhëna.

Kuvendi i komunës

Funksioni i kuvendit, komitetet, profilet e këshilltarëve, seanca, kryesuesi i kuvendit.

Në këtë link gjenden detyrat dhe përgjegjësitë e kuvendit të komunës. Ekzistojnë edhe të dhënat për komitetet, numrin e anëtareve të komiteteve, partisë që i takojnë etj. Tek profilet këshilltarëve, përpos emrit dhe partisë të cilës i takojnë, nuk ka të dhëna të tjera. Gjenden seancat e mbajtura në vitin 2006. Diçka te re nuk ka. Të dhënat për kryesuesin e kuvendit gjenden vetëm detyrat dhe përgjegjësitë.

Kryetari i komunës

Obligimet, profili, zëvendëskryetari.

Ekzistojnë të dhënat lidhur me obligimet e kryetarit dhe biografia e kryetarit. Ndërsa për nënkryetarin nuk ka të dhëna.

Drejtoritë

Listat e drejtorëve, kontaktet me drejtorët dhe vendimet e marra nga drejtoritë.

Në likun për drejtoritë janë të dhënat për drejtorët, adresat e drejtorëve, ndërsa sa i përket vendimeve të marra nga drejtoritë nuk ka të dhëna.

Buxheti dhe Projektet

Gjenden të dhënat lidhur me buxhetin e vitit të ardhshëm, pra vitin 2009. Edhe sa i përket projekteve ekzistojnë të dhëna.

Tenderët

Zyra për prokurim, tenderët e hapur.

Janë vetëm përgjegjësitë dhe detyrat e zyrës së prokurimit. Nuk ka të dhëna të tjera.

Dokumentacioni i juaj

Nuk ka të dhëna.

Shërbimet komunale

Përgjegjësitë e komunës, teknologjia informative, zyra për marrëdhënie me publikun, shërbime profesionale, ofiqari.

Përpos përgjegjësave të komunës që janë të cekura në këtë link nuk ka të dhëna të tjera.

Arkivi

Lajme, shpallje, arkivimi i tenderëve

Këtu janë të cekura lajmet e fundit në komunën e Podujevës, shpalljet e fundit në komunë si dhe arkivimi i dokumentacionit të tenderëve.

Lidhjet

Në këtë link gjenden ueb-faqet e institucioneve më të rëndësishme në Kosovë, qoftë vendore por edhe ato ndërkombëtare.

Vlerësimi mbi gjendje aktuale të web-faqes të komunës së Podujevës

Ueb-faqja e komunës së Podujevës munde të thuhet që përmban informacione,por shumica prej tyre janë të viteve të kaluara, pra nuk është bërë një freskim i rregullt ueb-faqes. Ueb-faqja e komunës së Podujevës përmban të dhëna në gjuhen serbe dhe angleze.

Rekomandim:

- Te linku për **qytetin** duhet te futet harta e qytetit e cila mungon në web faqe;
- Te linku **kuvendi i komunës** duhet të freskohen të dhënat lidhur me seancat e mbajtura, pasi që të dhënat janë nga viti 2006;
- Duhet të jenë të dhënat lidhur me nënkryetarin e komunës;
- Te Zyra e Prokurimit duhet të ketë të dhëna lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës, tenderët, hapjen e tyre, kontratat e lidhura me palët;
- Edhe pse konsiderohet link me rendësi shërbimet komunale, nuk përmban të dhëna që do të shërbenin për informimin e qytetareve;

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË PEJËS

KUVENDI KOMUNAL:

Fjala e kryetarit të komunës së Pejës:

Në këtë link gjendet deklarata e kryetarit të komunës drejtuar qytetarëve.

Asambleja komunale

Këtu gjenden detyrat dhe përgjegjësitë e kuvendit komunal të Pejës.

Statuti

I kompletuar gjendet statuti i komunës i miratuar nga anëtarët e kuvendit komunal.

Profili i kryetarit

Gjendet biografia e kryetarit të komunës së Pejës.

Rregulloret dhe vendimet

Këtu gjendet rregullorja mbi transparencën, rregullorja për dhënien e banesave me qira.

Komitetet

Në këtë link gjenden detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve si, komitetit për politikë dhe financa, komitetit për ndërmjetësim dhe për komunitete.

Profilet e këshilltarëve

Janë të cekura të gjithë emrat e këshilltarëve të kuvendit komunal, biografia politike e tyre. Të dhëna të tjera nuk ka.

Nënkryetarët e komunës

Gjendet biografia e nënkryetarëve të komunës.

Kryesuesit e kuvendit

Këtu gjendet biografia e kryesuesit të kuvendit dhe zëvendëskryesuesit.

ADMINISTRATA

Vende pune

Nuk ka të dhëna.

Drejtoritë

Të gjitha drejtoritë që veprojnë në kuvendin komunal, duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive.

Raportet

Nuk ka të dhëna.

Organogrami

Është paraqitur në mënyrë tabelore.

Tenderët

Nuk ka të dhëna.

Peja pret diasporën

Këtu gjenden të gjitha aktivitetet e kuvendit komunal të Pejës, lidhur me diasporën.

SHËRBIMET

Ofiqaria

Nuk ka të dhëna.

Urbanizmi

Nuk ka të dhëna.

Planet rregullative.

Nuk ka të dhëna.

Plani zhvillimor urban

Gjendet në mënyrë grafike.

PËR QYTETIN

Historia

Në këtë link gjendet historia e komunës së Pejës.

Kultura

Këtu gjenden të dhënat lidhur me të gjitha qendrat më të rëndësishme kulturore të komunës që shërbejnë në interes të qytetarëve.

Ekonomia

Gjenden dhënat lidhur me ekonominë e komunës së Pejës.

Sporti

Këtu gjenden të dhënat lidhur me palestrën e sporteve “Karagaq”, klubet sportive që veprojnë në komunë.

Pozita gjeografike

Gjenden të dhënat lidhur me pozitën gjeografike të komunës së Pejës.

Galeria

Këtu gjenden fotot e qendrave kryesore të komunës.

Harta e qytetit

Gjendet harta e qytetit në këtë link.

Shpalljet dhe informacionet e fundit

Në këtë link, janë të publikuara informacionet dhe shpalljet e fundit nga lëmitë e ndryshme me interes për qytetarët.

Vlerësimi mbi gjendjen aktuale të web-faqes të komunës së Pejës

Web - faqja e komunës së Pejës, kryesisht përmban informacione të mjaftueshme që shërbejnë në informim të qytetarëve dhe palëve të interesuara. Gjithashtu, të dhënat publikohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Rekomandim:

- Te linku **administrata** duhet të ketë të dhëna që janë me interes për qytetarët.
- Të dhënat lidhur me: ofiqarinë ,urbanizmin, planin rregullativ, mungojnë.

WEB-FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË SKENDERAJT

Asambleja komunale

Në këtë link gjenden vetëm emrat e anëtarëve të kuvendit komunal të Skenderajt.

Statuti

Këtu gjenden të dhënat lidhur me projekt statutin e komunës së Skenderajt.

Strategjia e zhvillimit

Plani strategjik i zhvillimit shoqëror, të dhëna të tjera nuk ka.

Fjala e kryetarit

Këtu është e cekur fjalimi i kryetarit të komunës së Skenderajt drejtuar qytetarëve.

Profili i kryetarit

Nuk ka të dhëna.

Lajmet

Këtu gjenden të dhënat e fundit që kanë të bëjnë me kuvendin komunal.

Profili i nënkryetarit:

Në këtë link gjendet biografia e nënkryetarit të komunës.

Harta e faqes

Ekziston në mënyrë tabelore.

Drejtoritë

Nuk ka të dhëna.

Drejtorët

Këtu gjenden vetëm emrat e drejtorëve.

Projektet

Gjenden projektet parësore për vitin 2008-2011.

Buxheti

Këtu gjenden të dhënat për buxhetin e vitit 2008. Nuk ka të dhëna të tjera.

Raportet

Raportet e zyrës së prokurimit, të dhëna të tjera nuk ka

Organogrami

Skema organizative e kuvendit komunal.

Ofiqaria

Nuk ka të dhëna.

Zyra pritëse

Historiku i zyrës, qëllimi i zyrës, rekomandimet. Të dhëna të tjera nuk ka.

Planet rregulluese

Nuk ka të dhëna.

Prokurimi

Nuk ka të dhëna.

Historiku

Historiku i shkurtër i komunës së Skenderajt.

Pak gjeografi

Pozita gjeografike e komunës.

Ekonomi

Nuk ka të dhëna.

Kultura

Ekzistojnë të dhënat lidhur me festivalin “Rapsodia Shqiptare”.

Sporti

Nuk ka të dhëna.

Galeria

Është e pasur me ca foto që pasqyrojnë pamje nga komuna e Skenderajt.

Tel. me rëndësi:

Nuk ka të dhëna

Harta e komunës

Këtu gjendet harta e Skenderajt.

Lidhjet me web

Edhe këtu janë ueb-faqet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Rrugët e qytetit

Edhe këtu nuk ka të dhëna.

Vlerësimi mbi gjendjen aktuale të web-faqes të komunës së Skenderajt

Ueb-faqja e komunës së Skenderajt nuk ka informacione të shumta që do të mund të shërbenin në informim të qytetarëve, mungojnë shumë të dhëna në linçe duke përfshirë edhe ato kryesore. Të dhënat në gjuhen serbe dhe angleze janë të njëjta me ato në gjuhen shqipe.

Rekomandim:

- Aktivitetet e komunës të jenë të publikuara gjerësisht.
- Te linku shërbimet mungojnë të dhënat dhe duhet të bëhet freskimi i tyre me informacione të reja.
- Të ketë më shumë të dhëna lidhur me drejtoritë, buxheti i komunës të jetë i pasqyruar më qartë.
- Futja e të dhënave në web faqe, freskimi i të dhëna, plotësimi me të dhëna i linçeve të cilat nuk përmbajnë fare të dhëna.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË PRIZRENIT

QEVERIA KOMUNALE:

Kryetari komunës

Në këtë link është paraqitur biografia e kryetarit të komunës, duke përfshirë aktivitetet politike.

Nënkryetarët e komunës

Edhe këtu është paraqitur biografia e nënkryetarëve.

Drejtorët

Këtu janë të cekur vetëm emrat e drejtorëve, të dhëna të tjera nuk ka.

Drejtoritë

Këtu janë të cekura detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive.

Vendimet e kryetarit të komunës

Janë të cekura vendimet e kryetarit të komunës të marra gjatë këtij viti.

Zyra për komunikim dhe informim

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës.

Lajmet

Janë paraqitur lajmet e fundit në komunën e Prizrenit.

Zyra për komunitete

Nuk ka të dhëna.

Prokurimi

Këtu janë të cekur emrat e stafit të zyrës së prokurimit dhe ligji mbi prokurimin publik të Kosovës.

Avokatura publike

Nuk ka të dhëna.

Përgjegjësitë

Këtu janë të cekura përgjegjësitë e pushtetit komunal.

KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi

Këtu është e cekur biografia e kryesuesit të komunës.

Zëvendëskryesuesi

Edhe këtu është paraqitur biografia e zëvendës kryesuesit.

Profilet e këshilltarëve

Janë të cekur emrat e këshilltarëve komunal, biografia e tyre.

Komitete

Këtu janë të cekura detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit për politikë dhe financa.

Funksioni i kuvendit

Në këtë link janë të cekura përgjegjësitë e kuvendit komunal. Të dhëna të tjera nuk ka.

Statuti

Këtu mund të gjeni statutin e kuvendit komunal të Prizrenit.

Rregulloret

Këtu gjenden rregulloret e fundit të miratuar nga kuvendi komunal.

Vendimet e kuvendit komunal

Gjenden vendimet e fundit të marra nga kuvendi i komunës së Prizrenit

Dokumentacioni i juaj

Nuk ka të dhëna.

PËR QYTETARËT

Zyra legale

Në këtë link gjenden detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës legale.

Ofiqaria

Nuk ka të dhëna.

Zyra pritëse

Nuk ka të dhëna.

Prizreni i vjetër

Këtu gjenden fotot e vjetra të qytetit të Prizrenit.

UDHËRRËFYESI

Historiku

Këtu gjendet historia e komunës së Prizrenit.

Pozita gjeografike

Pozita gjeografike e Prizrenit është e cekur në këtë link.

Prizreni- qyteti i trashëgimisë kulturore

Është e cekur trashëgimia kulturore e komunës së Prizrenit.

Ekonomia

Këtu ja të dhënat lidhur me zhvillimin ekonomik të komunës.

Sporti

Gjenden të dhënat që kanë të bëjnë me sportin, aktivitetet tradicionale sportive në komunë.

Galeria

Këtu gjenden fotot e qendrave kryesore të komunës.

Aktivitetet e komunës

Nuk ka të dhëna, gjenden të dhënat të vitit 2006. Nuk ka të dhëna të tjera.

Lidhjet me ueb- faqet:

Gjenden ueb-faqet e institucioneve më të rëndësishme si ato vendore po ashtu edhe ndërkombëtare.

Informatat

Ngjarjet e fundit që kanë të bëjnë me kuvendin komunal të Prizrenit.

Vlerësimi mbi gjendjen aktuale të web-faqes të komunës së Prizrenit

Në një vlerësim të përgjithshëm në lidhje me përmbajtjen e të dhënave në ueb faqes zyrtare të komunës së Prizrenit, mund të thuhet se ajo kryesisht mund të ofrojë informata për publikun dhe palët e interesuara. Po ashtu të dhënat publikohen në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe angleze.

Rekomandim:

- Web - faqja e komunës së Prizrenit duhet të përmbaj të dhënat lidhur me ofiqarinë dhe zyrën pritëse.
- Të dhënat lidhur me zyrën legale të freskohen me dokumente të reja.
- Aktivitetet e komunës duhet të freskohen pasi ato që janë prezantuar, janë nga viti 2006.

Edhe pse web faqja përmban informacione të shumta që shërbejnë për qytetarët, rekomandohet që të mirëmbahet dhe të freskohet vazhdimisht.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË SHTIMES

KUVENDI KOMUNAL:

Fjala e kryetarit

Fjala e kryetarit të komunës së Shtimes është paraqitur në web - faqen e komunës.

Asambleja komunale

Këtu gjenden detyrat dhe përgjegjësitë e kuvendit komunal.

Profili i kryetarit

Në këtë link, gjenden të dhënat lidhur me kryetarin e komunës, duke përfshirë ato politike dhe profesionale.

Rregulloret dhe vendimet

Gjenden te vendimet dhe rregulloret e fundit të marra ne kuvendin komunal, po ashtu edhe statuti i komunës.

Komitetet

Përpos komitetit për politikë dhe financa si dhe komitetit për komunitete, në këtë link, gjenden edhe komitetet e tjera që janë formuar në komunën e Shtimes.

Profilet e këshilltarëve

Këtu gjenden emrat e këshilltarëve të komunës, partia politike të cilës i takojnë.

ADMINISTRATA

Drejtoritë

Lista e drejtorive gjendet në këtë link.

Raportet

Raportet e viteve të kaluara gjenden këtu.

Buxheti

Gjendet buxheti i vitit 2004 dhe atij 2005.

Projektet

Nuk ka të dhëna.

Organogrami

Është paraqitur struktura organizative e drejtorive dhe asamblesë komunale.

Tenderët

Nuk ka të dhëna lidhur me tenderët.

SHËRBIMET

Ofiqari

Në mënyrë tabelore janë të dhënat lidhur me ofiqarin.

Urbanizmi

Nuk përmban të dhëna.

Planet rregullativ.

Nuk ka të dhëna.

Dokumentet, pyetjet e qytetarëve, plani zhvillimor urban, plani zhvillimor komunal:

Në këto linçe nuk ka të dhëna.

PËR QYTETITN:

Historia

Nuk ka të dhëna.

Kultura

Gjenden të dhënat lidhur me aktivitetet kulturore në komunën e Shtimes.

Ekonomia

Të dhënat e përgjithshme mbi ekonominë në komunë.

Sporti

Gjenden të dhëna të pakta lidhur me sportin.

Pozita gjeografike

Është e lansuar pozita gjeografike e komunës së Shtimes.

Galeria

Këtu gjenden fotot e qendrave kryesore të komunës.

Harta e qyteti

Gjendet harta e qytetit të komunës së Shtimes.

Informacione:

Gjenden informacionet e fundit që kanë të bëjnë me kuvendin komunal të Shtimes.

Vlerësimi mbi gjendjen aktuale të web-faqes të komunës së Shtimes

Ueb-faqja e kuvendit komunal të Shtimes nuk përmban të dhëna që do të shërbenin për informim të qytetarëve. Janë informacione të pakta. Sidomos në linçet kryesore nuk ka fare të dhëna. Edhe në disa prej tyre gjenden të viteve të kaluara. Sikur në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën serbe dhe angleze gjenden të dhënat.

Rekomandim:

- Linku i administratës duhet të plotësohet me të dhëna dhe të freskohet me dokumente të reja.
- Po ashtu linku shërbime duhet të plotësohet me të dhëna.
- Duhet të prezantohet edhe historiku i komunës së Shtimes.
- Aktivitetet e kryetarit të komunës të jenë të cekura në web – faqe.
- Freskimi i rregullt i të dhënave dhe publikimi i të dhënave në linçet ku ato mungojnë.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË OBILIQIT

Kuvendi komunal

Në këtë link nuk ka të dhëna.

Kryetari i komunës

Këtu është e cekur biografia e kryetarit të komunës së Obiliqit.

Rreth komunës

Është e precizuar pozita gjeografike e komunës.

Projekte

Nuk ka të dhëna.

Ekonomia

Gjenden të dhënat lidhur me ekonominë e komunës së Obiliqit duke përfshirë: energjetikën, agrikulturën, bizneset, agrobizneset.

Lajmet

Këtu gjenden lajmet e fundit që kanë të bëjnë me kuvendin komunal të Obiliqit.

Drejtoritë

Gjenden të gjitha drejtoritë që veprojnë në komunë, emrat e drejtorëve, biografia e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë.

Galeria

Këtu gjenden fotot e qendrave kryesore të komunës.

Kontakti

Janë numrat e telefonit të zyrave kryesore të kuvendit komunal.

Dokumentacioni

Statuti i komunës është i precizuar, të dhëna të tjera nuk ka.

Vende pune

Gjenden konkurset për vende të punës.

Shpalljet

Shpalljet e fundit të komunës. Njoftim për kontratë, statuti.

Vlerësimi mbi gjendjen aktuale të web-faqes të komunës së Obiliqit

Ueb-faqja e komunës së Obiliqit, nuk përmban të dhëna të shumta që do të shërbenin në informim të qytetarëve dhe palëve të interesuar. Edhe pse janë disa informacione shumica prej tyre janë të viteve të kaluara.

Ueb - faqja e komunës së Obiliqit përmban të dhëna në gjuhën serbe dhe angleze.

Rekomandim:

- Te linku kuvendi të futen të dhëna lidhur me këshilltarët e komunës, numrin e seancave të mbajtura, vendimet dhe rregulloret e miratuar nga kuvendi i komunës.
- Të jetë një renditje më e mirë e linçeve, pra një mirëmbajtje më me kujdes e web - faqes.
- Të futen të dhënat lidhur me aktivitetet e kryetarit të komunës, të drejtorive, të freskohen me informacione të reja.
- Futja e të dhënave të reja në linçet ku mungojnë ato dhe freskimi i të dhënave ekzistuese.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË RAHOVECIT

ORGANIZIMI I QYTETIT

Fjala e kryetarit

Në këtë link gjendet një deklaratë e kryetarit të komunës së Rahovecit drejtuar qytetarëve.

Struktura organizative

Është e paraqitur në mënyrë tabelore.

Buxheti

Gjenden të dhënat lidhur me buxhetin e viteve të kaluara.

PËR QYTETIN:

Histori

Historia e qytetit të Rahovecit, pozita gjeografike e komunës.

Kultura dhe sporti

Nuk ka të dhëna.

Ekonomia

Nuk ka të dhëna.

Galeria

Gjenden ca foto nga qyteti se si duket ditën dhe logo e komunës së Rahovecit.

Harta

Këtu gjendet harta e Kosovës dhe ajo e Rahovecit.

Popullsia

Gjenden statistikat e numrit të banorëve në vitin 2005.

KUVENDI I KOMUNËS

Në këtë link janë të paraqitura detyrat dhe përgjegjësitë e kuvendit komunal.

Komiteti

Janë të paraqitura komitetet që veprojnë në kuadër të kuvendit komunal, si komiteti për politikë dhe financa, komiteti për komunitete dhe komiteti për ndërmjetësim.

Profilet e këshilltarëve

Nuk ka të dhëna.

Seanca

Nuk ka të dhëna

KRYETARI I KOMUNËS

Obligimet:

Gjenden detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të komunës.

Profili personal

Në këtë link gjendet biografia e kryetarit të komunës.

Nënkryetaret e komunës

Biografia e nënkryetarëve të komunës.

Shefi i administratës she personelit

Gjendet biografia e shefit të administratës dhe personalit.

Drejtoritë

Në këtë link gjenden të dhënat lidhur me drejtoritë që veprojnë në komunën e Rahovecit, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorisë, kontaktet me drejtor. Të dhëna të tjera nuk ka.

Buxheti

Nuk ka të dhëna.

Projektet

Në mënyrë tabelore gjenden të gjitha projektet e kuvendit komunal.

Tenderët

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së prokurimit, tenderët e hapur. Nuk ka të dhëna të tjera.

DOKUMENTACIONI I JUAJ

Në këtë link gjenden formularët e ndryshëm të qytetarëve, raporti i punës së kryetarit të komunës.

SHËRBIMET KOMUNALE:

Në këtë link gjenden përgjegjësitë e pushtetit komunal, ndërsa zyra legale dhe zyra për informim nuk kanë të dhëna.

Arkivi

Gjenden lajmet e fundit në komunë, shpalljet e fundit, arkivimi i tenderëve.

Lidhjet

Ueb -faqet e kuvendeve komunale, ueb portali i Qeverisë së Kosovës.

Lajmet, shpalljet

Gjenden lajmet dhe shpalljet e fundit që kanë të bëjnë me kuvendin komunal të Rahovecit.

Vlerësimi mbi gjendjen aktuale të web-faqes të komunës së Rahovecit

Ueb -faqja e kuvendit komunal të Rahovecit nuk përmban të dhëna të shumta që do të shërbenin në informim të qytetareve dhe palëve të interesuar. Mungojnë shumë të dhëna në linçe, nuk janë të kompletuar me informacione të reja, nuk është bërë një freskim i të dhënave me informacione të fundit, shumë linqe që janë kryesore për p.sh. buxheti, mbledhjet e kuvendit komunal, zyra e prokurimit janë të zbrazura. Sikurse në gjuhën shqipe Ueb -faqja e komunës së Rahovecit përmban të dhëna në gjuhën serbe dhe angleze.

Rekomandim:

- Te linku për qytetin duhet të ketë të dhëna lidhur me sportin dhe kulturën, pasi që këto të dhëna janë me interes për qytetin.
- Linku për Ekonominë duhet të përmbaj të dhëna që kanë të bëjnë me sferën e ekonomisë për komunën e Rahovecit.
- Linku për kuvendin e komunës duhet të përmbaj të dhëna lidhur me profilet e këshilltarëve, numrin e seancave që janë mbajtur, po ashtu duhet të ketë edhe të dhëna lidhur me kryesuesin e kuvendit.
- Me qëllim të transparencës së komunës në raport me qytetarët komuna duhet të ofroj edhe të dhëna lidhur me zyrën e prokurimit.
- Futja e të dhënave të reja dhe freskimi i të dhënave ekzistuese.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Këtu janë të lansuar të gjitha të dhënat lidhur me ueb – faqen e komunës së Prishtinës.

Fillimi

Në këtë link janë të precizuar informacione lidhur me web-faqen e komunës funksionalizimin e saj, informacionet e fundit nga komuna e Prishtinës.

Fjala e kryetarit

Kjo ka të bëjë me fjalën e kryetarit të komunës lidhur me ueb faqen e komunës.

Profili i kryetarit të komunës:

Këtu është e cekur biografia e kryetarit të komunës së Prishtinës.

Asambleja komunale

Në këtë link janë të cekura përgjegjësit dhe kompetencat e kuvendit komunal duke përfshi miratimin e statutit, rregulloren e punës, buxhetin, raportet e kryetarit të komunës etj.

Shefi i administratës dhe personelit:

Nuk ka asnjë të dhënë për shefin e administratës.

Drejtoratet

Janë të cekura vetëm drejtoritë. Nuk ka të dhëna të tjera.

Raportet

Nuk ka asnjë të dhënë.

Organogrami

Në mënyrë tabelore është i dhënë dhe nuk vërehet fare.

Ofiqari

Në këtë link janë të dhënat lidhur me ofiqarin dhe shërbimin e regjistrimit, ku ofrohen informacionet për qytetarë, edhe këtu nuk ka informacione të shumta.

Zyra pritëse

Këtu janë të dhënat lidhur me shërbimet e qytetarëve se ku mundën të drejtohen. Ky link është mjaftë i pasur me informacione.

Urbanizmi

Janë të cekura detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorisë për planifikim dhe urbanizëm, nuk ka të dhëna të tjera.

Prokurimi

Edhe këtu janë vetëm detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së prokurimit, arkivimi i tenderëve.

Shërbimet publike

Përpos detyrave dhe përgjegjësitë e departamentit për shërbime publike dhe emergjencë, në këtë link ekzistojnë edhe të dhënat për trafikun urban, hortikulturën, rregulloret. Edhe këtu mungojnë shumë të dhëna.

Letrat e qytetareve

Nuk ka asnjë të dhënë.

Histori

Në këtë link ekzistoj vetëm disa të dhëna për numrin e banorëve të komunës së Prishtinës deri me vitin 1981 informacione të tjera nuk ka.

Pak gjeografi

Pozita gjeografike e komunës së Prishtinës, vendet ku mundën të vizitohen. Nuk ka të dhëna të tjera.

Ekonomi

Vetëm të dhënat për bizneset e komunës edhe atë është shumë i mangët. Nuk ka të dhëna të tjera.

Kulturë dhe sport

Në likun për kulturë, janë të dhënat lidhur me monumentet kulturore, biblioteka e qytetit, Universiteti i Prishtinës, shoqëritë e ndryshme kulturo-artistike që veprojnë në qytet, ndërsa sa i përket linkut të sportit vetëm informacione lidhur me ekipet sportive që veprojnë në komunë të Prishtinës. Të gjitha këto të dhënë janë shumë shkurt të precizuara.

Galeria

Ekzistojnë vetëm foto të sheshit Skënderbe, Prishtinës së vjetër, muzeut dhe qyteti i tashëm.

Telefonat me rëndësi

Janë të cekur vetëm numrat e telefonave të shërbimeve publike të komunës së Prishtinës.

Harta

Ekziston harta e komunës.

Lidhjet me web

Këtu janë informacionet lidhur me lidhjet me ueb faqet e institucioneve kryesore që veprojnë në Kosovë, si ato vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare.

Rrugët e qytetit

Këtu janë emrat e rrugëve të qytetit duke përfshi emrat e vjetër dhe ato të rinj.

Informacionet

Në këtë link ekzistojnë informacionet e fundit në komunën e Prishtinës.

Foto lajm

Buxheti i komunës së Prishtinës i miratuar nga kuvendi komunal.

Vlerësimi mbi gjendjen aktuale të web-faqes të komunës së Prishtinës

Në shikim të parë në një vlerësim të përgjithshëm në lidhje me përmbajtjen e të dhënave në ueb faqe zyrtare të komunës së Prishtinës, mund të thuhet se ajo kryesisht mund të ofroj informata për publikun dhe palët e interesuara, por nëse shikohet për çdo link, vërehet qartë se nuk ka informacione të shumta që do të shërbenin në informimin e qytetarëve, janë të dhëna të cilat nuk janë freskuar me informacione të reja. Po ashtu vlen të ceket se web - faqja e komunës së Prishtinës përmban të dhëna edhe në gjuhën serbe dhe gjuhën angleze.

Rekomandim:

- Te linku Qeveria, të futen të dhënat pasi që nuk përmban asnjë informacion që do të shërbente për qytetarët.
- Te linku qytetaret, të freskohen dokumentet, të futen informacionet e reja si: shërbimet publike, letrat e qytetarëve, të dhëna nga zyra e prokurimit.
- Freskimi i web- faqes me informacione të reja

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË ISTOGUT

Faqja Hyrëse

Faqja kryesore e ueb faqes të Komunës së Istogut konsiderohet të jetë e kompletuar, duke pasur parasysh se aty me hollësi paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune.

Edhe pse në këtë aspekt kjo faqe duket e kompletuar, në fakt nuk ofrohen të dhëna të kompletuara në të gjitha linçet.

Fillimi

Në këtë link paraqitet një pasqyrë e shkurtër e qytetit.

Qyteti

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Lajmet - ka të dhëna,

Historia - ekziston një historik i shkurtër rreth këtij qytetit.

Kultura - nuk ka të dhëna.

Popullsia - ka të dhëna .

Ky link funksionon pjesërisht.

Shërbime

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Vende pune - nuk ka të dhëna.

Dokumentacioni - nuk ka të dhëna.

Formularët - nuk ka të dhëna.

Njoftime - nuk ka të dhëna.

Ky link nuk funksionon.

Projekte

Në këtë link është paraqitur vetëm kjo dritare:

KIP: ka pjesërisht të dhëna

Kuvendi

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Kryetari - ka të dhëna.

Komitetet - ka të dhëna.

Këshilli i Drejtorëve - nuk ka të dhëna.

Kryeshefi ekzekutiv - nuk ka të dhëna.

Këshilltarët e Kuvendit - ka të dhëna.

Rregulloret - ka të dhëna të pjesërishme.

Drejtoratet - nuk ka të dhëna.

Buxheti - ka të dhëna të pjesërishme.

Ky link pjesërisht funksionon

Opinione

Ky link nuk funksionon.

Rekomandim:

- Të pasurohet pjesa e historikut me të dhëna kryesore të kësaj Komune;
- Të futen të dhëna rreth aktiviteteve kulturore të kësaj Komune ;
- Tek linku **SHËRBIME**, të futen të dhëna për: vendet e lira të punës, dokumentacionin, formularët dhe njoftime.
- Tek linku i Projekteve të publikohen edhe projekte të tjera të kësaj Komune;
- Dritarja e Kryeshefit Ekzekutiv të hiqet nga web linku, meqenëse me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale pozita e Kryeshefit Ekzekutiv nuk është e paraparë;
- Të futen të dhëna për të gjitha drejtoratet e Komunës;
- Të freskohen të dhënat rreth buxhetit;
- Linku **OPINIONE** të bëhet funksional.
- Të futen të gjitha rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal në web-faqen e kësaj Komune.

WEB FAQJA E KOMUNËS SË KAMENICËS

Faqja Hyrëse:

Faqja kryesore e ueb faqes së Komunës të Kamenicës konsiderohet të jetë përgjithësisht e kompletuar, duke pasur parasysh se aty me hollësi paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune.

Edhe pse në këtë aspekt kjo faqe duket përgjithësisht e kompletuar, në fakt nuk ofrohen të dhëna te kompletuara në të gjitha linçet.

Fillimi

Në këtë link ka të dhëna për seancën e fundit të mbajtur në këtë Komunë.

Kuvendi Komunal

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Fjala e Kryetarit - ka të dhëna.

Asambleja Komunale - ka të dhëna.

Nënkryetarët - ka të dhëna.

Statuti: ka të dhëna.

Profili i Kryetarit - ka të dhëna.

Rregulloret komunale - ka të dhëna.

Seancat: nuk ka të dhëna.

Vendimet komunale - nuk ka të dhëna .

Kryesuesi i Kuvendit - nuk ka të dhëna.

Komitetet - nuk ka të dhëna.

Ky link përgjithësisht funksionon.

Administrata

Në këtë link paraqiten këto dritare :

Drejtoritë - ka të dhëna.

ZLK(Zyra Lokale e Komunikimit) - nuk ka të dhëna.

Raportet - nuk ka të dhëna.

Buxheti - nuk ka të dhëna.

Projektet - nuk ka të dhëna.

Organogrami - nuk ka të dhëna.

Tenderët - nuk ka të dhëna.

Ky link funksionon pjesërisht.

Shërbimet

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Ofiqaria – ka të dhëna.

Shërbimi për qytetarët – ka të dhëna.

Zyra për Komunikim – ka të dhëna.

Për Kamenicën

Në këtë link paraqiten këto të dhëna:

Historia – ka të dhëna.

Kultura – nuk ka të dhëna.

Ekonomia – nuk ka të dhëna.

Sporti – nuk ka të dhëna.

Pozita gjeografike – nuk ka të dhëna.

Galeria – nuk ka të dhëna.

Harta e Kamenicës – nuk ka të dhëna.

Edhe ky link funksionon pjesërisht.

Lidhje

Në Këtë link paraqiten këto dritare :

Dokumente – ka të dhëna.

Shpallje – nuk ka të dhëna.

Lidhje Eksterne – nuk ka të dhëna.

E-mail – ka të dhëna

Ky link funksionon pjesërisht.

Komuniko Komunën

Në këtë link paraqitet vetëm kjo dritare:

Numërori telefonik – ka të dhëna.

Rekomandim:

- Tek linku **Kuvendi Komunal** të futen të dhëna për këto dritare: Seancat e Kuvendit Komunal, Vendimet e Kuvendit Komunal, të dhëna për kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe Komitetet.

- Tek linku **Administrata** të futen të dhëna në këto dritare: Zyra Lokale e Komunitetit (ZLK), të dhëna rreth Raportit, Buxhetit, Organogramit dhe Zyrës së prokurimit.
- Në linkun për Kamenicën meqenëse ka të dhëna vetëm për historinë e Komunës, duhet të ketë gjashtë dritare tjera (Kulturë, ekonomi, sport, pozita gjeografike, galeri, harta e Kamenicës);
- Tek linku **Lidhje** të futen të dhëna në dritaren Shpallje dhe Lidhje Eksterne.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Faqja Hyrëse

Faqja kryesore e ueb faqes të Komunës së Vushtrrisë konsiderohet të jetë e kompletuar, duke pasur parasysh se aty me hollësi paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune.

Fillimi

Në këtë link paraqitet një pasqyrë e përgjithshme e asaj se çka qytetarët dhe palët e tjera të interesuara mund të gjejnë më detajisht në këtë web – faqe zyrtare të Komunës.

Kuvendi

Në këtë link paraqiten këto dritare:
Funksionet e Kuvendit- ka të dhëna.
Përbërja e Kuvendit- ka të dhëna.
Rregullorja e Kuvendit - nuk ka të dhëna.

Ky link funksionon

Komitetet e Kuvendit

Në këtë link paraqiten këto dritare:
Komiteti për Politikë dhe Financa- ka të dhëna,
Komiteti për Ndërmjetësim - ka të dhëna.
Komiteti për Komunitete- ka të dhëna.

Ky link funksionon tërësisht.

Kabineti i Kryetarit

Në këtë link paraqiten këto dritare:
Kryetari -ka të dhëna.
Kabineti- ka të dhëna.

Edhe ky link funksionon.

Drejtoritë

Në këtë link paraqiten këto dritare:
Drejtoria për bujqësi - ka të dhëna.

Drejtoria për thesar, buxhet - ka të dhëna.
Drejtoria për urbanizëm - ka të dhëna.
Drejtoria për administratë - ka të dhëna.
Drejtoria për arsim - ka të dhëna.
Drejtoria për kulturë - ka të dhëna.
Drejtoria për inspeksion - ka të dhëna.
Drejtoria për kadastër - ka të dhëna.
Drejtoria për shëndetësi - ka të dhëna.
Drejtoria për shërbime publike - ka të dhëna.
Drejtoria për ekonomi - ka të dhëna.
Ky link është i kompletuar.

Organogrami

Edhe organografi ka të dhëna, që do të thotë se edhe ky link është funksional.

Udhërrëfyesi

Edhe linku i udhërrëfyesit ka të dhëna, që do të thotë se edhe ky link është funksional.

Rekomandim:

- Të futen të gjitha rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal në web-faqen e kësaj Komune.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË GLOGOCIT

Faqja Hyrëse

Faqja kryesore e web faqes të Komunës së Glllogocit konsiderohet të jetë e kompletuar, duke pasur parasysh se aty paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune.

Fillimi

Në këtë link paraqitet një pasqyrë e përgjithshme e asaj se çka qytetarët dhe palët e tjera të interesuara mund të gjejnë më detajisht në këtë web – faqe zyrtare të kësaj Komune.

Për Qytetin

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Arsimi – ka të dhëna,

Kultura – ka të dhëna.

Sporti – ka të dhëna .

Ekonomia -pjesërisht ka të dhëna.

Ky link konsiderohet të jetë funksional

Kuvendi Komunal

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Funksionet e Kuvendit- ka të dhëna.

Këshilltarët - ka të dhëna.

Seancat – janë të publikuara vetëm tri seanca.

Vendimet – nuk ka të dhëna.

Ky link funksionon përgjithësisht.

Kryetari i Komunës

Në këtë link nuk ka të dhëna për kryetarin e Komunës.

Departamentet

Në këtë link paraqiten të dhëna të përgjithshme për departamentet e kësaj Komune, por jo edhe të dhëna të veçanta për secilin departament.

Buxheti – edhe për këtë link ka të dhëna.

Projektet – ka të dhëna.

Tenderët – ka të dhëna.

Dokumentacioni juaj

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Formularët – nuk ka të dhëna.

Raportet - nuk ka të dhëna.

Rregulloret – ka të dhëna të pjesërishme.

Buletini – nuk ka të dhëna.

Ky link pothuajse nuk funksionon, meqenëse nga katër dritare sa ka ky link vetëm për njërin nga to ka të dhëna të pjesërishme.

Strategjia komunale

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Organogrami – ka të dhëna.

Kontakti - ka të dhëna.

Lidhjet në web – ka të dhëna.

Shpalljet e fundit –ka të dhëna.

Në dritaret për:

Dëshmorët – ka të dhëna.

Personat e zhdukur – ka të dhëna.

REKOMANDIME

- Tek linku **Kuvendi Komunal** të publikohen të dhënat për të gjitha seancat e mbajtura, dhe po ashtu të publikohen edhe vendimet e tjera të marra nga ky Kuvend.
- Tek linku **Kryetari i Komunës** të futen të dhëna për kryetarin e kësaj Komune.
- Të futen të dhëna në dritaren **Buletini**, formularët dhe raportet.
- Të bëhet freskimi edhe me Rregullore të tjera, meqenëse janë të publikuara vetëm tri Rregullore.
- Tek linku **Departamentet** të futen të dhëna për secilin departament.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Faqja Hyrëse:

Faqja kryesore e ueb faqes së Komunës të Kaçanikut konsiderohet të jetë përgjithësisht e kompletuar, duke pasur parasysh se aty me hollësi paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune.

Web - faqja e kësaj Komune nuk ka përkthim në gjuhët e tjera.

Edhe pse në këtë aspekt kjo faqe duket përgjithësisht e kompletuar, në fakt nuk ofrohen të dhëna të kompletuara në të gjitha linçet dhe dritaret e saj.

Faqja Hyrëse:

Faqja kryesore e ueb faqes të Komunës së Kaçanikut konsiderohet të jetë e kompletuar, duke pasur parasysh se aty me hollësi paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune.

Kuvendi Komunal

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Fjala e Kryetarit -në përpunim.

Profili i Kryetarit - ka të dhëna.

Nënkryetar i Komunës - ka të dhëna.

Kuvendi i Komunës - ka të dhëna.

Kryesuesi i Kuvendit - ka të dhëna.

Anëtarët e Kuvendit - në përpunim.

Komitetet - nuk ka të dhëna.

Rregullorja e punës së Kuvendit - është e publikuar.

Ky link konsiderohet të jetë funksional.

Qeveria

Ky link përbëhet nga këto dritare:

Drejtoritë:

Drejtoria për administratë - ka të dhëna.

Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale - ka të dhëna.

Drejtoria e arsimit dhe kulturës - ka të dhëna.

Drejtoria për financa, zhvillim dhe ekonomi - ka të dhëna.

Drejtoria e urbanizmit ,kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit - ka të dhëna

Drejtoria e emergjencës dhe shërbimeve publike - në përpunim.

Drejtoria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë - në përpunim.

]

Raportet

Në këtë link formalisht është publikuar Raporti i realizimit të buxhetit 2008, mirëpo ky raport nuk hapet. Duhet që në këtë link të plasohen raportet e drejtorive për përmbledhjen e punës së tyre.

Buxheti- është i publikuar buxheti i K.K Kaçanik për vitin 2008.

Projektet - është e publikuar lista e projekteve kapitale 2009-2011.

Organogrami - në përpunim.

Për qytetarët

Linku për qytetarët ka këto dritare:

Historiku - ka të dhëna.

Zyra e informimit - në përpunim.

Zyra e prokurimit - në përpunim.

Ofiqaria - në përpunim.

Arkiva e lajmeve - ka të dhëna.

Kontakti - ka të dhëna.

Ky link funksionon pjesërisht.

Rekomandim:

- Të futen të gjitha rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal në web-faqen e kësaj Komune.
- Të futen të dhëna për Komitetet obligative.
- Të publikohen raportet e drejtorive për përmbledhjen e punës së tyre.
- Kjo web - faqe të ketë përkthim edhe në gjuhën angleze dhe atë serbe.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Kjo Komunë nuk ka ueb – faqe zyrtare.

Rekomandim:

- Të hapet web faqja për Komunën e Hanit të Elezit në mënyrë që qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara t’ju mundësohet qasja direkte në punën dhe aktivitetet e Komunës së tyre.

WEB FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË JUNIKUT

Faqja Hyrëse:

Faqja kryesore e web faqes të Komunës së Junikut konsiderohet të jetë e kompletuar, duke pasur parasysh se aty në hollësi paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune. Kjo web - faqe ka përkthim të pjesërishëm edhe në gjuhën angleze dhe atë serbe.

Fillimi

Faqja kryesore e web faqes të Komunës së Junikut konsiderohet të jetë e kompletuar, duke pasur parasysh se aty paraqiten të gjitha aktivitetet e kësaj Komune.

Juniku

Në këtë link paraqitet një pasqyrë e kësaj Komune.

Ky link funksionon.

Kryetari

Në këtë link ka të dhëna për kryetarin e kësaj Komune.

Edhe ky link funksionon.

Zv.Kryetari

Edhe ky link përmban të dhëna për zv.Kryetarin.

Kryeshefi ekzekutiv

Edhe ky link funksionon.

Drejtoritë

Në këtë link paraqiten këto dritare:

Drejtoria administratës së përgjithshme - ka të dhëna.

Drejtoria për ekonomi,buxhet dhe financa - ka të dhëna.

Drejtoria për planifikim, urbanizëm dhe gjeodezi e kadastër. - ka të dhëna.

Drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport - ka të dhëna.

Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale – ka të dhëna.

Ky link është i kompletuar.

Shërbime

Edhe ky link konsiderohet të jetë i kompletuar.

Legjislacioni

Ky link përmban të dhëna për Statutin, Rregullore dhe formularë të ndryshëm.

Projektet 2006/07/08

Në këtë link janë të publikuara projektet e vitit 2006 dhe 2007, ndërsa projektet e vitit 2008 nuk janë të publikuara.

Rekomandim:

- Tek linku i **Projekteve** të publikohen edhe projekte të tjera të vitit 2008;
- Dritarja e Kryeshefit Ekzekutiv të hiqet nga web linku, meqenëse me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale pozita e Kryeshefit Ekzekutiv nuk është e paraparë.

WEB-FAQJA ZYRTARE E KOMUNËS SË KLINËS

Faqja Hyrëse:

Faqja kryesore e web faqes konsiderohet të jetë e kompletuar, duke pasur parasysh se aty me hollësi paraqiten të gjitha aktivitetet e komunës së Klinës.

Edhe pse në këtë aspekt kjo faqe duket e kompletuar, në fakt nuk ofrohen fare të dhëna për disa aktivitetet të komunës.

Kuvendi Komunal

Në këtë link paraqitet këto dritare të cilët paraqesim më poshtë si dhe funksionimin e tyre:

Fjala e kryetari - në këtë dritare ka të dhëna rreth fjalimit të kryetarit në fillim të vitit 2008,

Asambleja Komunale - përmban të dhëna rreth punës së Kuvendit Komunal,

Statuti- nuk përmban të dhëna,

Profili i kryetarit - Përmban të dhëna pra funksionon,

Rregullore dhe Vendime - Nuk përmban të dhëna,

Komitetet - kjo dritare e linkut kuvendi komunal pjesërisht funksionon,

Profilet e këshilltarëve - Funksionon pjesërisht,

Seancat - Nuk përmban të dhëna,

Zëvendës Kryesuesit -kjo dritare nuk funksionon.

Pra siç shihet edhe më lart ky link në faqen kryesore te ueb-faqes se Klinës funksionon pjesërisht pasi shumë të dhëna mungojnë.

Administrata

